



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

*Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

**Tiranë, më 16.12.2019**

**Dokument Parlamentar**

**RAPORT  
PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SH.T.Z.ILIR  
META, ME NR.11367,, DATË 25.11.2019, “PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM NË  
KUVEND TË LIGJIT NR.75/2019,“PËR RININË”**

**Hyrje**

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik mbështetur në nenet 81 dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve 18, 29, 34, 36, 38 dhe 70 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 16 dhjetor 2019 mori në shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës, z. Ilir Meta, me nr.11367, datë 25.11.2019 “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr.75/2019,“Për Rininë”.

Relatore për shqyrtimin e këtij dekreti është deputetja, znj. Almira Xhembulla.

Gjatë diskutimit të dekretit ishin të pranishëm: z.Bledar Dervishaj, këshilltar në Presidencë; znj. Voltisa Koçi, znj.Iva Beliu juriste të MASR.

**I.BAZA KUSHTETUESE E DEKRETIT**

Dekreti i paraqitur për shqyrtim mbështetet në nenin 85, pika 1, dhe nenin 93 të Kushtetutës.

**II. DISKUTIMI NË KOMISION**

Fillimisht, në Komision në mënyrë të përmbledhur paraqiti pikat kryesore të dekretit dhe dha shpjegime z.Bledar Dervishaj, këshilltar në Presidencë, i cili në mes të tjerash, theksoi se:

Presidenti i Republikës shqyrtoi ligjin nr. 75/2019, duke iu referuar përmbajtjes së aktit të dërguar për dekretim dhe shpallje, si dhe praktikës parlamentare të ndjekur për këtë qëllim, duke vlerësuar përputhshmërinë e këtij ligji me parimet dhe parashikimet e Kushtetutës së Shqipërisë,

aktet ndërkombëtare që Republika e Shqipërisë ka ratifikuar, si dhe interesin më të lartë të të rinjve shqiptarë.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij ligji, Presidenti i Republikës vlerëson se ky ligj bie në kundërshtim me parimet kushtetuese, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe fryma e këtij ligji nuk përputhet me interesat reale të të rinjve shqiptarë; për rrjedhojë ky ligj nuk është në harmoni me interesin publik e kombëtar. Presidenti i Republikës vlerëson se ky ligj nuk i përgjigjet nevojave të zhvillimit dhe pritshmërive të rinisë shqiptare dhe nuk garanton mirëqenien e tyre.

Presidenti thekson se: “Ligji jo vetëm që nuk sjell rregullimin e dëshiruar dhe të pritshëm, por për disa çështje thelbësore, ai bie ndesh me parimet dhe normat kushtetuese. Presidenti kërkon që të bëhet një studim objektiv dhe shumëplanësh përpara miratimit të një ligji të plotë për rininë. Për këtë Qeveria dhe Kuvendi të kenë strategji të qartë mbi mënyrën se si do të arrihet te rezultatet e pritshme pozitive.

Presidenti vë në dukje se : “Në disa dispozita të tij, ky ligj tenton vendosjen nën kontroll politik të organizimit rinor, gjë e cila do përbente cenim të rëndë të së drejtës të çdo të riu për t’u shprehur dhe për t’u organizuar lirisht.”.

Presidenti për kthimin e ligjit nënvizon, në mes të tjerash, se nenet 9 dhe 10 të ligjit nr.75/2019, bien ndesh me parimet kushtetuese dhe krijojnë mundësinë e një vartësie politike të drejtëpërdrejtë të organizatave rinore.... referuar më sipër, Presidenti i Republikës vlerëson se dispozitat e nenit 9 dhe 10 të ligjit nr.75/2019 duhet të rishikohen edhe njëherë nga Kuvendi i Shqipërisë me qëllim përmirësimin e tyre etj. Në këtë dekret Presidenti trajton dhe çështje të tjera që lidhen me ligjin “Për Rininë”

Përfaqësueset e MASR parashtruan një sërë argumentash, në përfundim të të cilave mbështeten plotësisht ligjin 75/2019 “Për Rininë” të miratuar në séancë plenare.

Relatorja, znj.Almira Xhembulla , vlerësoi ligjin e miratuar 75/2019 “Për Rininë” dhe u ndal gjërësisht në argumentat mbi qëllimin, risitë dhe parimet e këtij ligji. Ajo theksoi që ligji mori kohën e mjaftueshme para diskutimit në séancë plenare. Për këtë ligj paraprakisht Komisioni organizoi seanca dëgjimore me aktorë të interesit dhe bashkëpunoi ngushtë me Komisionin për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut për ta parë nga aspektet e teknikës legjislativë. Ndërkohë përmendi faktin që ky ligj është konsultuar në të gjitha qarqet e vendit.

Në vijim të diskutimit të saj, relatorja, znj. Almira Xhembulla, theksoi një sërë çështjesh, përfshirë institucionalizimin e pjesëmarrjes së organizatave rinore, si dhe rolin e tyre këshillimor në vendimmarrjen lokale dhe kombëtare.

Në mbledhjen e Komisionit diskutuan për çështje të dekretit kryetarja e Komisionit, znj. Fatjona Dhimitri, si dhe deputetët Ismet Beqiraj, Kostaq Papa, Erion Piciri.

Znj. Fatjona Dhimitri dhe z.Erion Piciri gjatë seancës së diskutimit të dekretit të Presidentit të Republikës u shprehën kundër ligjit të miratuar dhe mbështetën Dekretin e Presidentit të Republikës.

### **III. PËRFUNDIM**

Në përfundim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm u shpreh kundër dekretit të Presidentit të Republikës, z. Ilir Meta, me nr.11367, datë 25.11.2019 “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr.75/2019“Për Rininë” dhe i paraqet seancës plenare miratimin e këtij raporti.

**RELATORE**

**Almira XHEMBULLA**

**KRYETARE**

**Fatjona DHIMITRI**